

VENDIM
Nr. 598, datë 18.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIVITALIZIMI I PJESSHËM PRANË RRUGËS PEDONALE “ABAZ BEJ LUSHNJA”,
LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rivitalizimi i pjesshëm pranë rrugës pedonale “Abaz Bej Lushnja”, Lushnjë”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 320 397 (treqind e njëzet mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 320 397 (treqind e njëzet mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 7. Pronari i listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.
 10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

VLERA E SHPRONËSIMIT TË TRUALLIT TË Z. SHABAN DAUT BEQIRI, NË LAGJEN
“KONGRESI”, ZONA KADASTRALE 8571

Investitori: Bashkia Lushnjë

Nr.	N/pasurisë	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	18/19	Shaban Daut Beqiri	8571	Truall	m ²	33	9709	320397
						SHUMA TOTALE		320397